



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo



PARAJA PUBLIKE E SHPENZUAR NË MEDIA-2018

*Raport mbi shpenzimet financiare të
institucioneve për informim publik*



This project is
funded by EU



BALKAN
MONITORING
PUBLIC
FINANCES



Janar-Prill 2019

Prishtinë



**BALKAN
MONITORING
PUBLIC
FINANCES**



AUTORE: SIHANA KLISURICA

**DIZAJNI: ARGJIRA KUKAJ
FAQOSJA:**



*Ky projekt është përgatitur me asistencë financiare nga Bashkimi Evropian.
Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e partnerëve të projektit dhe
nën asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si pozitive reflektuese e
Bashkimit Evropian.*

PËRMBAJTJA

| | |
|---------------------------------|-------|
| Hyrje | 4 |
| Metodologjia | 5 |
| Përmbledhje | 6-8 |
| Institucionet e nivelit lokal | 9-32 |
| Institucionet e nivelit qendror | 33-45 |
| Përfundime dhe rekomandime | 46-47 |

I

HYRJE

Ky raport sjell të dhëna për pagesat që institucionet e nivelit qendror dhe lokal kanë bërë gjatë vitit 2018 në mediat vendore. Në bazë të informacioneve të mbledhura, analizës së kontratave të lidhura mes institucioneve dhe mediave, përgjigjeve ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike veçohet sidomos mos transparenca e institucioneve në procesin e përzgjedhjes dhe kontraktimit të mediave. Nga 61 institucione tek të cilat është dërguar Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, në mesin e tyre 21 ministri, 38 komuna dhe Zyra e Presidentit e Kuvendi i Kosovës, vetëm 35 kanë kthyer përgjigje. Shumica prej tyre kanë dërguar tabela me shifrat e pagesave që janë bërë për media të caktuara, por jo të gjitha institucione kanë dhënë sqarime se për çfarë arsye janë bërë ato pagesa. Një tjetër aspekt që ia vlen të ceket është mos respektimi i afatit ligjor që parashihet në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike¹ ku në Nenin 9 në pikën 1 thuhet se:

“Kërkesa për rishqyrtimin e çështjes duhet të shqyrtohet brenda shtatë (7) ditësh prej kohës së regjistrimit të kërkesës për rishqyrtimin e çështjes”. Një numër i institucioneve kanë kthyer përgjigje me një muaj vonesë, edhe atë pas kontaktimit të vazhdueshëm për t’ua rikujtuar se kanë shkelur afatin ligjor. Për të parë se sa janë shumat e shpenzuara dhe për çfarë arsye janë bërë pagesat e caktuara, janë analizuar kontratat e gjetura në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe “E-Prokurimi”. Po ashtu janë marrë referenca nga raporte të ndryshme ndërkombëtare të cilat flasin për gjendjen e mediave në Kosovë dhe mënyrën e financimit të tyre. Hulumtimi është realizuar brenda periudhës 4 mujore, janar-prill 2019.



METODOLOGJIA

Të gjitha të dhënat e mbledhura në këtë raport, janë mbledhur brenda një periudhe katër mujore, prej muajit janar deri në muajin prill të vitit 2019. Për përpilimin e raportit, gjatë periudhës së hulumtimit janë përdorur metoda dhe burime të ndryshme. Fillimisht është dërguar një Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike tek të gjitha institucionet vendore, të pushtetit qendror dhe lokal. Kjo kërkesë e përpiluar në gjuhën shqipe dhe serbe për komunat me shumicë serbe, është dërguar përmes postës elektronike. Pas marrjes së përgjigjes janë analizuar të dhënat e dërguar, duke i krahasuar ato më pas me kontratat e gjetura në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit.

Më pas janë monitoruar disa media online dhe reklamat e institucioneve që ato kanë publikuar në faqet e tyre.

Pjesë e këtij hulumtimi ka qenë po ashtu edhe analiza e kontratave që institucionet kanë lidhur me media të ndryshme në vend. Përgjigjet e ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike si dhe kontratat e gjetura kanë qenë si burime kryesore të analizës që i është bërë shpenzimeve që institucionet kanë bërë në mediat vendore përgjatë vitit 2018.



PËRMBLEDHJA

Problem i përhershëm i mediave në Kosovë mbetet qëndrueshmëria e tyre e dobët financiare. Duke pasur parasysh ekonominë e dobët të vendit, ekziston një paqëndrueshmëri e madhe financiare edhe në mediat e Kosovës.

Në vend momentalisht botohen 5 gazeta ditore: “Koha Ditore”, “Kosova Sot”, “Zëri”, “Bota Sot” dhe “Epoka e Re”, televizione me shtrirje nacionale janë RTK, KTV, Klan Kosova, TV Dukagjini, T7, RTV21, Tribuna.

Numri i saktë i portaleve që operojnë në vend nuk dihet saktë.

Gjithashtu pothuaj secila komunë e ka televizionin e vet lokal, dhe media online që më shumë merren me informimin e publikut në komunën përkatëse. Në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës janë të anëtarësuara 34 media të shkruara dhe online. KMSHK nuk ka të dhëna apo listë të mediave online në total që operojnë në Kosovë, por ka dhënë një shifër të përafërt që mund të jetë rreth 250 portale, mirëpo këto të dhëna janë të pakonfirmuara.

Në një shtet si Kosova me më pak se 2 milionë banorë operojnë diku rreth 250 media vetëm online, dhe 184 radio e kanale televizive (të licencuara në Komisionin e Pavarur për Media) dhe 5 gazeta.

Numri i madh i medimeve në vend, veçanërisht atyre online, është shqetësues për faktin se për një pjesë të madhe të tyre nuk dihet pronësia. Kjo lë hapësirë për shpërndarjen e lajmeve të rrejshme dhe mos profesionalizmit në raportim.

Ashtu edhe siç përmendet në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2018² në pjesën ku flitet për lirinë e shprehjes. Aty thuhet se *“subjektet mediale përgjithësisht nuk janë ekonomikisht të qëndrueshme”*.

Derisa theksohet se informata për struktura të pronësisë së mediave, veçanërisht atyre online, mbesin të paqarta dhe shpeshherë fiktive. Tek në fillim të vitit 2017 mediat kanë filluar të publikojnë impresumin, apo të dhënat e botuesit, megjithatë mungesa e një strategjie financiare për mediat i bën ato të varen nga burime të tjera financiare gjë që lë hapësirë që ato të kenë ndikim dhe të mbështeten financiarisht nga subjekte politike të cilat i shfrytëzojnë mediat për t'i shtyrë përpara agjendat e tyre.

Shqetësues mbetet fakti se si tek mediat online gjen edhe reklama të institucioneve të ndryshme, e kur më pas klikon në atë reklamë lidhja direkte bëhet me faqen e institucionit. Disa media janë analizuar për dy muaj me radhë për të parë se sa qëndrojnë këto reklama. Prej muajit shkurt e deri në muajin prill, periudha që përfshin ky hulumtim, reklama të institucioneve kanë qëndruar në ballinat e portaleve.

“Ekonomia Online” për shembull në këndin e reklamave, në anën e djathtë të faqes, poshtë, në atë që shkruan Reklama del logoja³ dhe emri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komuna e Ferizajt.

E njëjta vlen edhe për portalin “Indeksonline”⁴ i cili në fillim të faqes ka reklamën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Po ashtu edhe portalet “Gazeta Metro”⁵ e “Periskopi”⁶ kanë të njëjtën reklamë në ballinë. Këto janë vetëm disa prej mediave online që shfaqin reklamat e institucioneve në ballinat e tyre. Ajo që vihet re është se Komunitat më shumë kanë shpenzuar para tek mediat që operojnë në regjionin e asaj komune për reklama dhe përcjellje të aktiviteteve të atij institucioni. Ndërsa për publikime të konkurseve dhe shpalljeve të tjera janë bërë pagesa tek gazetat vendore.

Edhe Ministritë kanë shfrytëzuar gazetatat për shpallje të konkurseve dhe botimeve të tjera, por sa i përket mediave online më shumë gjenden të specifikuar si “shërbime për informim publik”, apo edhe ndjekje të aktiviteteve të ministrisë së caktuar. Këto shërbime shkojnë deri në pikën kur mediumi i caktuar ka kontratë me Ministrinë për të përcjellë aktivitetet e ministrit përkatës.

³<https://ekonomiaonline.com/>

⁴<https://indeksonline.net/>

⁵<https://gazetametro.net/>

⁶<https://www.periskopi.com/>

Kjo tregon edhe për shumat e mëdha që institucionet shpenzojnë në media dhe se si i shfrytëzojnë ato për të promovim të vetin. Në këtë rast Ministria e Infrastrukturës mund të merret si shembull për të shpjeguar më mirë këtë gjendje. Është institucioni i vetëm i cili Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike nuk i është përgjigjur me e-mail. Për dallim, kjo ministri ka lejuar qasje në dokumente vetëm me prezencë fizike. Fakti që përmbledhja financiare e shpenzimeve për media e kësaj ministrie ka qenë e qasshme për ta analizuar për së afërmi ka mundësuar që gjithë këtij hulumtimi t'i jep kahje tjetër. Sikur të gjitha institucionet tjera do ta bënin të njëjtën gjë me siguri se shifrat e shpenzimeve, të mbledhura më poshtë, do të rezultonin tjera. Në këtë formë ka qenë e mundur që të analizohen të gjitha pagesat e bëra, përkundër faktit se zyrtarë të kësaj ministrie janë mundur t'i fshehin disa prej tyre duke i nënvizuar si shpenzime të detyrueshme e po ashtu edhe vendosjen e një letre mbi shifrën reale.

Ajo që paraqitet më poshtë, në analizën e secilës përgjigje të marrë nga institucionet shihet qartë se ka mospërputhje informacionesh mes atyre që ministritë apo komunat kanë dërguar dhe kontratat e gjetura ne KRPP. Mos transparenca dhe fshehja e informacioneve nga institucioneve është tregues i qartë për ndikimin që ato kanë në media të caktuara.

përgjigjur me e-mail. Në bazë të përgjigjeve të dërguara nga 35 institucione të nivelit lokal dhe qendror totali i shpenzimeve në media për vitin 2018 është **598,917.71** euro. Kjo shumë është nxjerrë në bazë të tabelave dhe informatave që Ministritë dhe Komunat e caktuara kanë dërguar. Më poshtë janë përmbledhur dhe analizuar të gjitha informatat e gjetura rreth këtyre shpenzimeve që institucionet e Kosovës kanë bërë në mediat vendore.

KOMUNAT

1.KOMUNA E SHTIMES

Përgjatë vitit 2018 del se Komuna e Shtimes ka shpenzuar **4,214.70** euro në publikime, shpallje dhe njoftime. Nga muaji i dytë i vitit 2018 kjo komunë ka shpenzuar paratë në reklama e konkurse në shumën minimale prej **34** euro deri në atë maksimale prej **560**. Mediat në të cilat Komuna e Shtimes i ka dërguar një tabelë ku janë të specifikuar shpenzimet për reklamat dhe publikimet e konkurseve e po ashtu edhe shpenzimet për informim të publikut janë në “Shpërndarja Express” dhe “Radio Zëri i Shtimes”.

Zyrtari i kësaj Komune ka bërë të ditur se nuk kanë pasur forma të tjera të financimit për media gjatë vitit, derisa kontratat me këto dy medime figurojnë edhe në faqen zyrtare të “E-Prokurimi”. Për Reklama dhe Konkurse në total janë shpenzuar: **1,724 .97** euro. Për “Shpenzimet për informim të publikut” në total janë shpenzuar: **2,489**



2.KOMUNA LIPJAN


Në bazë të përgjigjes ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente publike, të dërguar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Komuna e Lipjanit ka dërguar një tabelë me shpenzime. Sipas saj, përgjatë vitit 2018 Komuna e Lipjanit në total ka shpenzuar **5,125.50** euro në mediat vendore.

Shpenzimet i kanë ndarë në dy kategori: “Reklama dhe konkurse” dhe “Botimet e publikimeve”. Në kategorinë e parë kjo komunë ka shpenzuar **1,723.75** euro ndërsa të dytën **5,125.50** euro. Prej 80 pagesave sa janë bërë gjatë vitit të kaluar nga Komuna e Lipjanit, një është në publikuar në gazetën “Koha Ditore”, katër në agjencinë e lajmeve “Ekonomia Online”, ndërsa 75 të tjera në gazetën “Zëri”. Por asnjë prej këtyre shpenzimeve apo kontratave të lidhura me medime nuk figurojnë në KRPP.



3.KOMUNA E PEJËS

Në dokumentet e dërguara nga Komuna e Pejës, si përgjigje ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, janë dy tabela me shpenzimet që kjo komunë ka bërë gjatë vitit 2018 në mediat vendore. E para, në të cilën përfshihen shpallje dhe publikime në mediat si “Kosova Sot”, “Grupi Koha”, “Shpërndarja Express” dhe “First Media Group”. Totali i këtyre shpenzimeve, sipas përgjigjes së Komunës së Pejës, është **6,618.00** euro. Në tabelën tjetër hyjnë “Shpenzimet mediale”, për “Radio Tv Dukagjinin” dhe “Radio Peja”. Shuma totale e këtyre faturave është **5,300.00** euro. Në total, sipas përgjigjeve të pranuar, del se kjo komunë ka shpenzuar **11,918.00** euro për vitin 2018 në media.



4.KOMUNA E DRENASIT

Gjatë vitit 2018, Komuna e Drenasit ka shpenzuar në total **3,270** euro në mediat vendore. Në bazë të përgjigjes dhe dokumenteve që kjo komunë ka dërguar hyjnë tri kategori të shpenzimeve. Për “Botime e publikime” Komuna e Drenasit ka shpenzuar në total **722.50** euro, ku hyjnë publikimet e banerave, konkurseve, broshurave për festa, në mediat “Drenica Onlie” dhe “Zëri”. Në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është gjetur vetëm një kontratë⁷ e këtyre shpenzimeve dhe ajo është e lidhur me median “Drenica Online” me titullin “Publikimi i aktiviteteve të Komunës së Drenasit dhe vendosja e banerit”.

Ndërsa në kategorinë e “Reklamave dhe konkurseve”, ku hyjnë shpallja e konkurseve, pagesa e internetit, po ashtu edhe njoftime e urime, janë shpenzuar në total **2,412.50** euro. Këto konkurse janë bërë në mediat si “Koha Ditore”, “Zëri”, “Ekonomia Online”. E në kategorinë e fundit që e kanë ndarë si “Shpenzime për informim publik” hyjnë njoftime në radio dhe urime për vitin e ri, në “Radio Drenasi” dhe në gazetën “Epoka e Re”.



5. KOMUNA HANI I ELEZIT

Komuna Hani i Elezit gjatë vitit 2018 ka shpenzuar në total **1,197** euro në pagesat që ka bërë në mediat vendore. Në këtë mes hyjnë publikime, konkurse e po ashtu edhe “Përcjellja e Aktiviteteve për nevoja të Komunës Hani i Elezit”. Kjo nënkupton se Komuna ka paguar TV Dielli që të përcjellë seancat por edhe aktivitetet e tjera të këtij institucioni. Në mesin e tyre edhe aktivitetet për Ditën e Çlirimit dhe një urim për Fitër Bajram. Pagesat për publikime dhe konkurse të gjitha janë bërë në të përditshmen “Zëri”, ndërsa përcjellja e aktiviteteve në TV Dielli. Kontrata me shumën më të vogël është **25** euro, ndërsa më e larta **96** euro.

Në faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) janë gjetur dy kontrata⁸ të nënshkruara nga Komuna Hani i Elezit dhe dy medimeve të përmendura më lartë. Kontrata me TV Dielli është në vlerë prej 970 euro ndërsa ajo me gazetën “Zëri” **742** euro. Totali i këtyre dy kontratave është **1,702 euro, 505** euro më shumë se të dhënat që kjo komuna ka dërguar.



⁸<https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=151501>

6.KOMUNA E RAHOVECIT


Komuna e Rahovecit i është përgjigjur Kërkesës së Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës për Qasje në Dokumente Publike me vetëm një kontratë. Kjo kontratë e titulluar “Shërbimet e transmetimit të Kuvendit të dhe Shërbime të tjera për Komunën e Rahovecit”⁹ është e lidhur mes Komunës së Rahovecit dhe “Radio Aktiv” e cila kap shumën prej **4,608.00** euro. Kontrata, sipas dokumentit të dërguar ka hyrë në fuqi më datën 19 të muajit e katërt (4) të vitit 2018 dhe përfundon me datën 18 të muajit prill të vitit 2019.

Në përshkrimin e detajuar të kësaj kontrate hyjnë:

-Transmetimi direkt i mbledhjeve të Asamblesë Komunale; shuma **1,854.00** euro.


-Regjistrimi i mbledhjeve të asamblesë komunale dhe ritransmetimi i tyre (si dhe arkiva për Kuvendin Komunal); shuma **1,764.00** euro

-Transmetimi i Njoftimeve për mbledhjet Asamblesë Komunale (10 herë brenda ditës). Njoftimi, sipas kontratës, duhet të bëhet 14 ditë para datës së mbledhjes së Asamblesë Komunale. Kostoja e këtij shërbimi arrin shumën prej **990.00** euro.



7.KOMUNA E VUSHTRISË

Komuna e Vushtrisë, është një prej institucioneve që ka respektuar periudhën kohore për kthimin e përgjigjes, megjithëse përgjigjja ndaj kërkesës ka qenë e mangët. Është dërguar vetëm një përmbledhje e shumës së shpenzuar dhe emrat e mediave pa arsyetimin se për çfarë janë shpenzuar ato para. Shuma totale sipas kësaj përgjigje është **6,375.68 €**. Aty shkruhet se për gazetën “Kosova Sot” janë dhënë **1,020.00 €**, “First Media Group” **1,360.00 €**, “Zëri” **202.00 €**, “Vicianum” **3,298.68 €** dhe për “No Prokultpress” **495.00 €**.



8. KOMUNA JUNIK

Sipas përgjigjes ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike për shpenzimet dhe pagesat në mediat vendore për vitin 2018, del se Komuna e Junikut në total ka shpenzuar **3,640** euro. Në tabelën që ka dërguar kjo Komunë, janë të dhënat për shpenzime në tri media, por nuk është përcaktuar arsyeja e shpenzimeve. Për median “Kosova e Lirë” Komuna e Junikut ka dhënë **1,920** euro, për “Gazeta Projekti” **1,000** dhe për gazetën “Epoka e Re”, **720** euro. Asnjë prej këtyre kontratave nuk është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit.



9.KOMUNA E GRAÇANICËS

Në mesin e komunave me shumicë serbe, Komuna e Graçanicës është e vetmja e cila i është përgjigjur Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike. Në bazë të 10 kontratave që ka dërguar Komuna e Graçanicës, si përgjigje ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, shihet se ky institucion ka kontraktuar dy medime. Bëhet fjalë për gazetën “Epoka e Re” dhe “Radio 038 Graçanica”. Me të parën, për vitin 2018 ka 7 kontrata në shumë totale prej **595** euro. Në këtë gazetë janë bërë publikime të departamenteve të ndryshme, por nuk ceket se për çfarë arsye. Ndërsa në “Radio 038 Graçanica”, ku janë shpenzuar **270** euro, janë shpallur konkurse për vende të lira të punës. Në total Komuna e Graçanicës, në bazë të kontratave që ka dërguar del të jetë **865** euro.



10.KOMUNA E GJAKOVËS

Komuna e Gjakovës i është përgjigjur Kërkesës së Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, për Qasje në Dokumente Zyrtare me katër kontrata. E para janë shpenzimet për të gjitha publikimet, ku hyjnë shpalljet dhe konkurset, në të përditshmen "Koha Ditore". Sipas këtyre të dhënave del se gjatë vitit 2018 kjo Komunë ka shpenzuar **11,656** euro në këtë drejtim.

Komuna e Gjakovës po ashtu ka kontrata dy vjeçare me "TV Syri Vision". E para kap shumë prej **50,000** euro. Kjo kontratë është lidhur më 03.05.2016 deri më 03.05.2018, që i bie se për pesë muajt e parë të vitit të kaluar ka shpenzuar **10,410.65** euro. Kontrata e dytë e lidhur më 12.06.2018 deri më 12.06.2019 është në vlerë prej **24,999.96** euro, që i bie se për gjashtë muajt e tjerë të vitit ka shpenzuar **12,499.98** euro.

Këto dy kontrata me "TV Vision" përcaktojnë që ky televizion të "përcjell dhe pasqyroj të gjitha aktivitetet e Kabinetit të Kryetarit, Asamblesë Komunale, të gjitha Drejtorive të Komunave dhe institucioneve të tyre bartëse, në kanalin televiziv, ueb-faqe, kanalin 'YouTube' dhe rrjete sociale".

Ndërsa kontrata e fundit është me agjencinë e lajmeve "Kosova Press", po ashtu për të kryer shërbime për Komunën e Gjakovës. Në marrëveshje parashihet që "Kosova Press" të "publikoj banerin e Komunës së Gjakovës lidhur me linkun e ueb faqes, në ueb faqen e Agjencisë së Lajmeve 'Kosova Press'", të "publikoj komunikata, konkurse dhe njoftime në ueb faqen e 'Kosova Press' dhe shkrime të tjera me karakter informativ mbi aktivitetet e përgjithshme të Komunës së Gjakovës" si dhe "marrjen e materialit me video të aktiviteteve të Komunës me kërkesë të zyrtarit të informimit dhe publikimi i videove në faqe zyrtare të Komunës së Gjakovës, marrjen e materialit deri në dy aktivitete me video në muaj". Kjo kontratë është nënshkruar për periudhën 12.03.2018 deri më 12.03.2020. Pagesa për muaj është **500** euro, që i bie se për nëntë muajt e vitit 2018 Komuna e Gjakovës ka paguar **4,500** euro. Totali i shpenzimeve dhe pagesave që ka bërë kjo komuna për vitin 2018 i bie në vend të i bie përdor shprehje tjera si: rezulton, të jetë **39,066.63** euro.

11. KOMUNA E VITISË

Komuna e Vitisë gjatë vitit 2018 ka shpenzuar në total **12,446.99** euro në mediat vendore, për “Botime të publikimeve”, “Reklama dhe konkurse”, dhe “Shpenzime për informim të publikut”. Më pas këto shpenzime ndahen edhe në shpenzime të komunës dhe të hyra vet-anake. Janë gjithsej 10 media të ndryshme tek të cilat janë bërë pagesat për secilën prej kategorive të cekura më lartë. Në mesin e tyre “Zëri”, “Smart Media”, “Grupi Koha”, “Kryeljami”, “Faxpress”, “Radio Kosova e Lirë”, “Rajoni Press”, “Shpërndarja Express”, “Gjilani Info” dhe “Radio Zëri i Pozheranit”.



12. KOMUNA E ISTOGUT

Në bazë të të dhënave të pranuar nga Komuna e Istogut mbi shpenzimet e parasë publike në media, totali për vitin 2018 del të jetë **5,580** euro, sipas tabelës së shpenzimeve që ka dërguar kjo komunë. Aty paraqiten tri media përfituese. Bëhet fjalë për gazetën “Bota Sot” tek e cila janë shpenzuar **300** euro, për “Shpërndarja Express” **2,290** dhe kompania “Meshari” në kuadër të së cilës funksionon “Radio fontana”, për të cilën janë shpenzuar **2,990** euro. Por pas analizimit në ueb faqen “E-Prokurimi” është gjetur një kontratë e nënshkruar mes kësaj komune dhe kompanisë “Meshari” në shumë prej **9,950.00** euro. Titulli i kësaj kontrate është “Publikim i njoftimeve në radio për nevoja të komunës”.¹⁰ Nga kjo del se ky institucion, pavarësisht kërkesës për qasje në dokumente publike, nuk ka dhënë informatat reale dhe të plota.

E po ashtu në përgjigjen e Komunës së Istogut nuk janë dhënë informacione se për çfarë arsye janë shpenzuar ato para, por janë dhënë vetëm informacione se cila drejtori ka bërë pagesa dhe shumën e tyre.



13. KOMUNA E PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2018 ka shpenzuar në total **11,522.6** euro në mediat vendore. Për reklama dhe konkurse, në gazetën “Epoka e Re”, ka shpenzuar **5,513** euro, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve për informim publik janë shpenzuar **6,009.60** euro. Këtu hyn furnizimi me gazeta ditore, publikime në Gazetën Zyrtare e po ashtu edhe të tjera në “TV Opinioni”. Kjo e fundit është kontraktuar për të transmetuar mbledhjet e Asamblesë së Kuvendit Komunal.



14. KOMUNA E GJILANIT

Shifra e shpenzimeve që ka dërguar Komuna e Gjilanit në total është **13,535.82** euro, për vitin 2018. Janë gjithsej 16 media vendore tek të cilat kjo komunë ka bërë pagesa. Megjithëse në përgjigjen e kësaj Komunë në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike nuk janë dhënë informacione të detajuara se për çfarë arsye janë bërë këto shpenzime, janë dërguar në mënyrë elektronike vetëm mediat tek të cilat janë bërë pagesat. Mediumet tek të cilat janë bërë këto pagesa janë: “Kryelajmi”, “Insajderi”, “Radio Star”, “Radio Rinia”, “Bota Sot”, “Shpërndarja Express”, “Radio Gjilani”, “Kosova Sot”, “Rajoni Press”, “Gjilani Info”, “Zëri”, “Shqiptari”, “2lonline” dhe “Gurpi KOHA”. Në këtë mes hyn edhe shuma prej **160** euro që është bërë në Zyrën e Kryeministrit.

Prej të gjithë pagesave në këto media janë dërguar shumat e shpenzimeve. Në rastin e pagesës për “Radio Star” në tabelën e dërguar nga Komuna e Gjilanit totali është **4,895.82**, ndërsa në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është gjetur një faturë e nënshkruar më **23.01.2018** me vlerë prej **8,249.30** euro¹⁷



15. KOMUNA E MALISHEVËS

Në bazë të përgjigjes që ka dërguar Komuna e Malishevës, janë dy paragrafë ku janë përshkruar shpenzimet e kësaj komune në mediat vendore për vitin 2018.

“Komuna e Malishevës ka një marrëveshje bashkëpunimi me Radio Kosova e Lirë dhe gjatë vitit 2018 për shërbimet e kryera nga RKL, në bazë të marrëveshjes, kemi paguar shërbimet në vlerë prej **2,400** euro”, shkruhet në përgjigjen e Komunës së Malishevës ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike të dërguar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës.

“Po ashtu me Gazetën Epoka e Re i publikojmë Reklammat dhe Konkursset janë paguar **2,950** euro dhe për Botimet e Publikimeve janë paguar **3,850** euro, pra llogaritur si total për gazetën Epoka e Re janë paguar **6,800** euro”, shkruhet aty më tej. Totali i shpenzimeve të kësaj Komune në media vendore është **9,200** euro.



16. KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT

Komuna e Mitrovicës në përgjigjen e saj ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike ka dërguar vetëm disa të dhëna të shkruara. Ka specifikuar se kjo komunë nuk ka dhënë subvencione për media gjatë vitit 2018, ndërsa për shpenzime ka njoftuar se ka shpenzuar **20,400.00** euro në vit.

“Sa i përket pagesave/shpenzimeve të Komunës për vitin 2018 ndaj mediave vendore, ju informoj se Komuna jonë ka paguar **10,200.00** euro për TV Mitrovica dhe nga kjo shumë **1,700.00** euro kanë qenë borxh për dhjetor 2017, ndërsa pjesa tjetër janë pagesa për 2018”, është shkruar në përgjigjen e Komunës së Mitrovicës, derisa është specifikuar se ky institucion ka kontratë me “TV Mitrovica” për përcjelljen dhe transmetimin e të gjitha aktiviteteve të Komunës së Mitrovicës. Shuma në baza mujore për këtë shërbim kap vlerën prej **1,700.00** euro.



17. KOMUNA E DRAGASHIT

Komuna e Dragashit për vitin 2018 ka shpenzuar në total **8,882.92** euro në media. Kjo komunë në përgjigjen e saj nuk është treguar transparente mjaftueshëm. Në bazë të një tabele të vogël me tre kolona, janë dërguar vetëm tri kategoritë e shpenzimeve por jo edhe mediu-met. Për “Reklama dhe konkurse” janë dhënë **2,7323.90** euro, për “Botimet e Publikimeve” janë dhënë **975** euro ndërsa në kategorinë “Shpenzime për informim të publikut” **5,175** euro.




18. KOMUNA FUSHË KOSOVË

Komuna e Fushë Kosovës në përgjigjen e parë në Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike ka shkruar se “bazuar në kërkesën tuaj për Qasje ne Dokumente Publike ku keni kërkuar që të qasni në të dhënat për subvencione ose grante për të gjitha mediat, ju njoftojmë se në bazë të shënimeve të pranuar nga shërbimet tona kemi marrë përgjigje se nuk kemi pranuar asnjë faturë për shërbime të tilla”. Pas tentimit të dytë dhe sqarimit se Kërkesa ka qenë e qartë dhe se përveç përmendjes së subvencioneve përfshihen të gjitha llojet e shpenzimeve të institucionit në media. Pas kësaj Komuna e Fushë Kosovës ka dërguar një tabelë me raport të shpenzimeve, ku janë të specifikuar llojet e pagesave e po ashtu edhe mediumet. Shuma totale sipas kësaj table, të shpenzimeve të Komunës së Fushë Kosovës në media për vitin 2018, del të jetë **990** euro.




19. KOMUNA PODUJEVË

Komuna e Podujevës ka dërguar dy tabela me shpenzime që ka bërë brenda vitit 2018 në mediat vendore. E para është një reklamë për tatim në pronë në “Radio Llapë” me vlerë prej **300** euro. Ndërsa tjetra me “Shpërndarja Express” për “Konkurs edhe publikime”, “Reklama dhe konkurse” dhe “Publikim të konkursit” me vlerë totale prej **1,292.00** euro. Në total i bie që kjo komunë ka shpenzuar **1,592** euro në media.



20. KOMUNA E KAMENICËS

Në bazë të përgjigjes së Komunës së Kamenicës ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike të dërguar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, del se kjo komunë për vitin 2018 në total ka shpenzuar **3,260.00** euro. Kjo Komunë ka dërguar të dhënat për shumën e shpenzimeve dhe kategoritë e përgjithësuar por jo edhe për cilat media. Aty hyjnë “Reklamat dhe Konkursat” në shumë prej **2,330.00** euro dhe “Shpenzimet për informim publik” në shumë prej **930.00** euro. Në përgjigje është specifikuar që nuk ka subvencione e po ashtu se “**750** euro kanë mbetur borxhe për këtë vit, 2019, nga viti i kaluar”.



21. KOMUNA E PRISHTINËS

Komuna e Prishtinës nga buxheti i saj vjetor për vitin 2018 ka shpenzuar në total **26,986.14** euro për publikimin e shpalljeve dhe konkurseve në media vendore.

Në bazë të informacioneve të mangëta të dërguara nga kjo komunë, si përgjigje ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, janë tri media tek të cilat janë bërë këto publikime. Këtu hyjnë gazeta “Koha Ditore” tek e cila janë paguar **18,089.71** euro, gazeta “Zëri” ku janë paguar **8,296.43** euro dhe gazeta “Epoka e Re” me pagesa në shumë prej **600.00** euro.



22. KOMUNA E KAÇANIKUT

Të gjitha pagesat që Komuna e Kaçanikut ka bërë në media, sipas informatave që ka dërguar, janë bërë për "Informim të publikut". Ndërsa në përgjigjen bashkëngjitur me tabelën e shpenzimeve, thuhet se "tek gazeta 'Epoka e Re' të gjitha pagesat janë bërë për konkurset e shpallura publike që është obligim ligjor, ndërsa mënyra e përzgjedhjes ka shkuar përmes tenderit". Shuma totale e pagesave për këtë medium është **1,080** euro. Ndërsa pagesa të tjera në shumë prej **2,842.8** janë për median "Radio Kosova e Lirë" dhe një pagesë tjetër në përgjigjen e Komunës së Kaçanikut është për "Shtypshkronjën Era" në shumë prej **160** euro. Totali i shpenzimeve të kësaj komune në media është **3,002.84** euro.



23. KOMUNA E KLINËS

Komuna e Klinës në përgjigjen ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike për shpenzimet e vitit 2018 ka dërguar katër tabela me pagesa për katër media të ndryshme. E para është për “Shpërndarja Express” ku hyjnë pagesat për: “furnizim për zyre”, “konkurse” dhe “reklama dhe konkurse”. Totali i pagesave për këtë medium, sipas tabelës që ka dërguar kjo komunë është **2,100** euro. Por në faqen zyrtare të “E-Prokurimi” është gjetur një kontratë¹² me këtë kompani me vlerë prej **6,300.00** euro e cila nuk është përmendur në përgjigjen e Komunës së Klinës. E dyta është për gazetën “Epoka e Re” ku hyjnë pagesat për Konkurse dhe Publikime. Shuma totale është **4,810** euro.

Pagesat tjera janë bërë për median “Radio Kosova e Lirë”, nën kategorinë “Shërbim kontraktues” në total prej **1,800** euro. Mediumi tjetër është “Radio Alba” e cila është paguar për transmetim të seancave të Kuvendit Komunal e po ashtu edhe për informim publik. Shuma total për këto shërbime është **500** euro.



¹² https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=249649

**Tabela 1: Totali i shumave të shpenzimeve në media për secilën komunë që ka kthyer përgjigje*

| Komunat | Totali |
|---|------------------|
| 1.Komuna e Shtimes | 4,214.70 |
| 2.Komuna e Lipjanit | 5,125.50 |
| 3.Komuna e Pejës | 11,918 |
| 4.Komuna e Drenasit | 3,270 |
| 5.Komuna e Hanit të Elezit | 1,197 |
| 6.Komuna e Rahovecit | 4,608.68 |
| 7.Komuna e Vushtrrisë | 6,375.68 |
| 8.Komuna e Junikut | 3,640 |
| 9.Komuna e Graçanicës | 865 |
| 10.Komuna e Gjakovës | 11,656 |
| 11.Komuna e Vitisë | 12,446.99 |
| 12.Komuna e Istogut | 5,580 |
| 13.Komuna e Prizrenit | 11,522.60 |
| 14.Komuna e Gjilanit | 13,535.82 |
| 15.Komuna e Malishevës | 9,200 |
| 16.Komuna e Mitrovicës së Jugut | 20,400 |
| 17.Komuna e Dragashit | 8,882.92 |
| 18.Komuna e Fushë Kosovës | 990 |
| 19.Komuna e Podujevës | 1,592 |
| 20.Komuna e Kamenicës | 3,260.14 |
| 21.Komuna e Prishtinës | 26,986.14 |
| 22.Komuna e Kaçanikut | 3,002.80 |
| 23.Komuna e Klinës | 4,810 |
| Totali i shpenzimeve të Komunave | 175,079.9 |

I

ZYRA E PRESIDENTIT

Në përgjigjen nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, thuhet se Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike e dërguar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është shqyrtuar nga departamentet përkatëse. Por kjo përgjigje është shumë e mangët, pasi që është dërguar vetëm shuma totale pa sqarime shtesë se për çfarë janë shpenzuar ato para e as tek cilat media.

“Ju njoftojmë se nga Zyra e Presidentit janë shpenzuar gjithsej **30,479.00€**. **15,700.00€**, janë shpenzuar për banera në 10 vjetorin e Pavarësisë, ndërsa shuma tjetër për shpallje të ndryshme gjatë vitit”, shkruhet në përgjigjen e Zyrës së Presidentit. Këtu nuk është specifikuar se ku është shpenzuar shuma e mbetur, tek cilat media apo edhe çfarë lloji të shpalljeve. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka kërkuar informacione shtesë, por nuk ka marrë përgjigje.

Në faqen zyrtare të “E-Prokurimi” janë gjetur dy kontrata të nënshkuara nga Zyra e Presidentit. Njëra është e lidhur me “Rilindjen” me titull “Njoftim për nënshkrim të kontratës për furnizim me shtyp ditor”¹³. Vlera e kësaj kontrate është **7.076,70 €**. Ndërsa kontrata tjetër është e lidhur me agjencinë e lajmeve “Kosova Press” me titull “Shërbime të agjencisë së lajmeve”¹⁴ me vlerë prej **9,600.00€**.

¹³ https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=268244

¹⁴ https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=192827

MINISTRITË

1. MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

Në total kjo Ministri për vitin 2018 ka shpenzuar **1,732.92** euro në mediat vendore ky hyjnë publikimet e konkurseve dhe njoftimeve të ndryshme. Në përgjigjen ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, dërguar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, kjo Ministri ka dërguar një tabelë me shpenzimet që ka bërë në media të shkruara. Në këtë listë hyjnë gazetatat si “Koha Ditore”, “Epoka e Re”, “Zëri”, “Bota Sot” dhe “Kosova Sot”.

2. MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në përgjigjen e këtij institucioni ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike për shpenzimet në media gjatë vitit 2018, është thënë se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka marrëveshje bashkëpunimi me gazetatat ditore për publikime të ndryshme të ministrisë, siç janë konkurset, shpalljet publike etj, si dhe kontrata me disa media online – portale për promovimin e programeve mbështetëse të ministrisë për fermerët dhe agrobizneset. “Po ashtu duhet të theksoj se në totalin e shpenzimeve të vitit 2018, janë të bartura edhe disa obligime të vitit 2017 për media”, thuhet në përgjigjen e kësaj ministrie. Më tej aty është thënë se “MBPZHR nuk jep subvencione apo grante për media, pasi që kjo mbështetje është orientuar vetëm për fermerët dhe agrobizneset vendore”.

Totali i shpenzimeve të kësaj ministrie, sipas tabelës së dërguar, është **46,371.00** euro ku hyjnë 28 media të ndryshme. Në këtë tabelë, shumat nuk janë specifikuar llojet e pagesave. Ndërsa në faqen zyrtare të “E-Prokurimi” është gjetur një kontratë¹⁵ e nënshkruar me datën 17.07.2018 lidhur me agjencinë e lajmeve “Kosova Press” në vlerë prej **9,888.00** euro me titull “Dokumentar për shërbimet këshiluese në nivel kombëtar”. E në tabelën e dërguar nga kjo ministri pagesat për “Kosova Press” janë në vlerë prej **3,400.00** euro..

3. MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në bazë të të dhënave të dërguara nga Ministria e Administratës Publike, në përgjigjen ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, del se ky institucion për vitin 2018 ka shpenzuar në total **6,922.00** euro. Këto shpenzime janë bërë në nëntë media të ndryshme, për publikime dhe reklama e konkurse. Ndërsa sa i përket subvencioneve apo granteve ky institucion ka njoftuar se nuk ka të tilla. Por ky institucion nuk ka dërguar informatat në lidhje me kontratën që kishte lidhur me “Rilindja”. Kjo kontratë¹⁶ e publikuar në “E-Prokurimi” me titull “Furnizim me gazeta ditore dhe periodike për nevoja të MAP”. Vlera e kësaj kontrate është **11,439.36** euro.

4. MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Në bazë të përgjigjes së kësaj ministrie në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, gjatë vitit 2018 ka bërë pagesa në gazetën “Koha Ditore” në shumë prej **467.00** euro për reklama dhe konkurse. Ndërsa në pagesa të tjera hyn edhe media online “Alb Info” për të cilën ka ndarë subvencion me shumë prej **2,300.00** euro. Totali i shpenzimeve, në bazë të vetëm këtyre informatave që ka dërguar ky institucion është **2,767.00** euro.

¹⁵ https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=206119

¹⁶ https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=133196

5. MINISTRIA E FINANCAVE

Ministria e Financave sipas informacioneve të dërguara, ka shpenzuar **10,848.00** euro për vitin 2018 në mediat vendore. Në bazë të tabelës me mbledhjen e shpenzimeve mes tjerash është dhënë përshkrimi i llojit të pagesës, kompania dhe shuma. Kompania e parë është “ACI” me pagesa në total prej **5,200** euro për konkurse. Kjo kompani bën publikimin e konkurseve në gjuhën serbe. Pas saj është gazeta “Epoka e Re” po ashtu për konkurse në shumë prej **450** euro, me të njëjtën shumë dhe të njëjtin përshkrim është edhe kompania “First Media Group”. Një tjetër kompani që kjo ministri ka bërë pagesa për konkurse dhe botime të publikimeve është “Grupi Koha” në total prej **2,715**. Në këtë mes është edhe gazeta “Kosova Sot” me shumë prej **420** euro, “Shpërndaja Express” me 180 euro dhe “Zëri” me **1,433** euro.

6. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS

Për dallim nga institucionet tjera, Ministria e Infrastrukturës, ka lejuar Qasje në Dokumente Publike vetëm me shikim të dokumenteve. Pas analizës së raportit financiar të kësaj ministrie për shpenzimet që i ka bërë gjatë vitit 2018 në mediat vendore totali ka qenë është **140,046.71**. Në këtë shumë zyrtarë të kësaj ministrie kanë nënvizuar disa shpenzime që i konsideronin obligative siç është mbledhja e shtypit ditor. Pa këto shpenzime shuma totale del të jetë **131,441.01** euro. Mirëpo ajo që është vërejtur në këtë listë të shpenzimeve është se mes tjerash janë nënvizuar edhe shërbime të tjera nën emrin “Media Works”, e cila është kategorizuar si media por që më pas është specifikuar si marketing në “Shpërndarja Express” me shumën prej **600** eurove, për tri të tilla sa ishin pjesë e atij dokumenti. Ndërkohë që si mbledhje e shtypit ditor janë të kategorizuara “Gazeta Zyrtare” dhe “Rilindja”. Edhe pse e përmendur si shpenzim për mbledhjen e shtypit ditor në fakt shuma e këtij shërbimi dallon dukshëm nga muaji në muaj, duke nisur prej shumës **35** euro deri në **524** euro. Në disa raste është parë se këto dy shuma janë bërë edhe brenda një muaji të vetëm.

Në këtë dokument të Ministrisë së Infrastrukturës shpenzimet janë ndarë në tri kategori: “Shpenzimet për informim publik” me total shpenzime prej **14,230** euro; “Shpenzimet e marketingut” në total prej **14,200** euro dhe; “Mallrat e shërbimet” në total prej **13,000** euro. Totali i këtyre tri kategorive është **41,230** euro. Kjo shumë nuk përkon me totalin, ani pse në dokumentin e prezantuar ishin shpenzimet e ndara në këto kategori. Mospërputhja e të dhënave e po ashtu edhe tentimi për t’i fshehur disa shpenzime të caktuara janë tregues të mos transparencës së kësaj ministrie. Mes tjerash është vërejtur se pagesat nga Ministria e Infrastrukturës janë bërë për pasqyrim të aktiviteteve, shpenzime për informim publik, pagesa për shërbime e po ashtu edhe për botime të konkurseve. Njëkohësisht nën kategorinë ku ishin të përmbledhura emrat e mediave të shumta që kjo ministri ka bërë pagesa për shërbime të ndryshme, është edhe “Media Consult”. Tek kjo pjesë specifikohet mbulimi i vizitave të zëvendësministrit, vizita inspektuese në punimin e autostradës, nisja e punimeve, xhirimeve dhe përgatitjeve të videove për dërgim. Përkundër faktit se shpenzimet e kësaj ministrie janë të mëdha, asnjë kontratë nuk është gjetur në faqet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik e as në “E-Prokurimi”.

7. MINISTRIA E DREJTËSISË

Kjo ministri ka shpenzuar në media nga buxheti i saj në vitin 2018 **1,732.92** euro. Fillimisht kjo ministri ka dërguar vetëm shumën totale të pagesave që ka bërë në mediat vendore dhe një arsyetim për këtë përgjigje.

“Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2018 ka publikuar 8 (tetë) konkurse të jashtme në gazetate ditore. Ministria e Drejtësisë konkurset i publikon në gazetate ditore në rotacion dhe shuma totale e pagesave për publikime është **1,733**. Ju informojmë se Ministria e Drejtësisë nuk ka dhënë subvencione ose grante për asnjë medium gjatë vitit 2018”, shkruhet në përgjigjen e kësaj ministrie. Pas kërkesës për informata më të detajuara, ka dërguar edhe një tabelë më të detajuar me të dhëna mbi departamentin përkatës i cili ka bërë pagesat, llojin e shpalljes dhe mediumet ku këto pagesa janë bërë.

8. MINISTRIA PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në përgjigjen ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike të dërguar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, për shpenzimet e parasë publike në media gjatë vitit 2018 ka thënë se për asnjë media nuk ka dhënë subvencione e as grante. Ndërsa shuma e përgjithshme e shpenzimeve nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në mediumet e Kosovës për vitin 2018 është **31,903.32** euro. Kjo është ilustruar edhe në tabelën që ka dërguar kjo ministri me shumën e paguara tek kompanitë mediale në vend. Në këtë tabelë janë prezantuar të dhënat për emrat e kompanive mediale dhe shumën por nuk janë paraqitur edhe arsyet e shpenzimeve. Bëhet fjalë për dhjetë mediale të ndryshme tek të cilat janë bërë pagesa prej shumës më të ulët prej 181.35 euro deri më **21,750.00** euro. Kjo shumë

9. MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Ministria e Integrimit Evropian sipas përgjigjes ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike për shpenzimet në media gjatë vitit 2018, dërguar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, del se ka shpenzuar **5,599** euro. Në bazë të informatave të paraqitura në një tabelë kontrata për informim publik. Këtu hyjnë edhe kontratat me shtypshkronja për dizajnim dhe shtypje të broshurave “për nevoja të fushatës së liberalizimit të vizave” si dhe kontrata me kompani për “shërbime të përkrahjes së llogarive poseduese në rrjete sociale për nevoja të Ministrisë së Integrimit Evropian”. Po ashtu aty janë përfshirë edhe kontratat me media siç janë “Ekonomia Online” dhe “Indeksonline” nën përkrahimin “Shërbime informuese mediale për nevoja të MIE-së”.

10. MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përveç se ka dërguar përgjigjen me një muaj vonesë, përkundër faktit se në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike është cekur edhe ligji i cili përcakton afatin ligjor për përgjigje, informacionet janë të mangëta. Përveç shumës totale për shpenzime gjatë vitit 2018 dhe një arsyetimi se çfarë lloj pagesa kanë bërë, nuk ka dërguar informacione të detajuara.

“Gjatë vitit 2018, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka shpenzuar **54.900.00€** për mediat në vend, të cilat kanë përcjellë dhe publikuar aktivitetet e MPMS-së (komunikatat, njoftimet, ftesat, shpalljet, spotet publicitare, të gjitha këto me karakter informativ), si dhe kanë afishuar linkun e MPMS-së në faqet e tyre”, është shkruar në përgjigjen e kësaj ministrie. Njëkohësisht është dhënë edhe një sqarim se kjo ministri nuk ndanë subvencione apo grante për media.

11. MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bazë të përgjigjes që ka dërguar ndaj Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike për shpenzimet në media gjatë vitit 2018, del të ketë shpenzuar në total **90,536** euro. Bëhet fjalë për pagesa që ka bërë në 15 media të ndryshme vendore. Shuma e pagesave për një medium të vetëm arrin deri në **20 mijë** euro, derisa në tabelën ku janë paraqitur këto shifra nuk është dhënë ndonjë sqarim se për çfarë arsye janë bërë ato pagesa. Mediat që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka bërë pagesa janë gazeta “Epoka e Re”, mediat “Ekonomia Online”, “Shpërndarja Express”, “Infokus”, “Kosova Press”, “Gazeta Metro”, “Insider”, “Grupi Koha”, “Indeks Online”, “Kosova Sot”, “KultPlus”, “Media Works”, “Prizren Press”, “Radio Kosova e Lirë” dhe gazeta “Zëri”.


Tabela 2: Totali i shumave të shpenzimeve në media për secilën ministri që ka kthyer përgjigje, dhe Presidenca e Kosovës.

| Ministrite | Totali |
|--|-------------------|
| 1.Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 1,732.92 |
| 2.Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | 46,371 |
| 3.Ministria e Administratës Publike | 6,922 |
| 4.Ministria e Diasporës dhe Investigimeve Strategjike | 2,767 |
| 5.Ministria e Financave | 10,848 |
| 6.Ministria Infrastruktues | 140,046.71 |
| 7.Ministria e Drejtësisë | 1,732.9 |
| 8.Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës | 31,903.32 |
| 9.Ministria e Integritimit Evropian | 5,599 |
| 10.Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 54,900 |
| 11.Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 90,536 |
| Totali i shpenzimeve të Ministrive | 393,358.87 |


Tabela 3: Totali i shpenzimeve i institucioneve te nivelit qendror dhe lokal në media për vitin 2018, duke u bazuar në përgjigjet nga 23 komuna dhe 11 ministri dhe Zyra e Presidencës.

| <i>Institucionet</i> | <i>Shuma</i> |
|-----------------------------|---------------------|
| Ministritë | 393,358.87 |
| Komunat | 175,079.92 |
| Presidenca | 30,478.92 |
| | 598,917.7 |


Grafikoni 1: Në këtë grafikon paraqiten llojet e pagesave dhe shumat e mbledhura për secilën gazetë, duke u bazuar në informatat dhe shifrat e dërguara nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror.



Grafikoni 2: Në këtë grafikon paraqiten llojet e pagesave dhe shumat e mbledhura për televizione, duke u bazuar në informatat dhe shifrat e dërguara nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror.



Grafikoni 3:Në këtë grafikon paraqiten llojet e pagesave dhe shumat e mbledhura për portale, duke u bazuar në informatat dhe shifrat e dërguara nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror.



GAZETA EKONOMIA

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

800€

SHESHI

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

400€

TELEGRAFI

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

2,400.00€

PERISKOPI

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

1,200€

ORA INFO

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

6,600.00€

GAZETA METRO

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

6,900.00€

LAJMI NET

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

1,200.00€

KOSOVA PRESS

shërbime të
marketingut/reklama

79,636.63€

INSIDER

shfrytëzimi hapësirës
reklamuese

7,821.00€

INFOKUSI

publikim i artikujve/
reklama

4,800.00€

INDEKSONLINE

publikim i artikujve/
reklama

1,400.00€

GAZETA PRISHTINA

publikim i artikujve/
reklama

200€


EKONOMIA ONLINE

publikim i artikujve/shër-
bime të marketingut/
publikim banerit


22,700€

BLIC MEDIA

1,200.00€



Grafikoni 3 :Në këtë grafikon paraqiten llojet e pagesave dhe shumat e mbledhura për radio, duke u bazuar në informatat dhe shifrat e dërguara nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në bazë të gjetjeve të prezantuara në këtë raport si problem kryesor del të jetë mos transparenca e institucioneve karshi shpenzimeve që ato i bëjnë në mediat vendore. Po ashtu edhe shumtë e pagesave të bëra pa pasur një bazë të përzgjedhjes së mediumit në aspektin e lexueshmërisë apo besueshmërisë. Publikimi i reklamave në portale pa pasur një arsye të caktuar për promovim, është një tjetër çështje. Fakti se në një vend si Kosova, me një numër më pak se 2 milionë banorë, supozohet të operojnë rreth 250 portale të cilave nuk u dihet pronësia, lë hapësirë që institucionet t'i shfrytëzojnë ato për qëllimeve të veta partiake.

Një gjë të tillë do të duhej të rregullohej përmes anës ligjore e cila do të siguronte mbështetja financiare për media pa pasur nevojë për ndërhyrjen e politikës. Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë asnjë hap që të gjejë një zgjidhje sa i përket rregullimit të çështjes së pronësisë e as transparencës së mediave në raportim. Këto çështje janë paraparë dhe rekomanduar edhe në Raportin e Progresit të vitit 2016 e po ashtu përmenden edhe në atë të vitit 2018. Si shqetësim aty ngrihet pikërisht fakti se këto rekomandime nuk janë marrë parasysh, e as nuk janë adresuar.

Në faqen zyrtare të Reporterët pa Kufij, kur klikon emrin e Kosovës, e para del një përshkrim me titullin “Ndërhyrja politike”, e cila veçanërisht flet për këtë pjesë të varësisë së mediave ndaj politikës.

Aty thuhet se: *“Media kosovare vuan nga ndërhyrja direkte dhe indirekte e politikës, presioni financiar dhe pronësia e koncentruar. Gazetarët që kritikojnë autoritetet kosovare shpesh akuzohen dhe cilësohen si ‘tradhtar’ apo ‘simpatizues të Serbisë’...”*¹⁷

E tillë pasqyrohet gjendja përderisa nuk bëhet asgjë për ta ndryshuar atë. Prandaj edhe “Freedom House in the World” në statusin e lirisë së medias e kategorizon si “Pjesërisht të lirë”.¹⁸

Ky raport përveç se përmbledhë në një vend shumtë e shpenzuara nga institucionet vendore të parasë publike në media, po ashtu mëton të vë në pah mënyrën se si funksionon lidhja mes institucioneve dhe mediave.

¹⁷<https://rsf.org/en/kosovo?nl=ok>

¹⁸<https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/kosovo>

Në bazë të informatave të marra nga institucionet dhe më pas analizimit të tyre del se mediat online janë më të prekura nga ndërhyrja politike e cila më pas ndikon drejtpërdrejtë edhe në politikat e tyre redaktoriale. Fakti se ato përdoren më shumë për reklama të institucioneve përkatëse, apo edhe kanë kontrata për të ndjekur aktivitetet e tyre nënkupton se edhe raportimi më pas është i njëanshëm. Pra portalet më shumë shfrytëzohen si platforma për të ndjekur agjendat e caktuara duke humbur e rolin e medias si një ndërmjetës mes publikut dhe institucioneve. Kështu media online me këtë formë të bashkëpunimit që ka me institucione të ndryshme po rrezikon që dalëngadalë të shndërrohet në zëdhënës të tyre.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

Luan Haradinaj 100/10
10000 Pristina
Republika e Kosovës

www.agk-ks.org



**BALKAN
MONITORING
PUBLIC
FINANCES**